



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**  
**Komisioni për Ekonominë dhe Financat**

Tiranë, më 16.12.2022

**Dokument parlamentar**

**Komision përgjegjës**

**R A P O R T**

**PËR AKTIN NORMATIV NR.17, DATË 1.12.2022 “PËR DISA NDRYSHIME DHE  
SHTESA NË LIGJIN NR.115/2021 “PËR BUXHETIN E VITIT 2022”, TË  
NDRYSHUAR**

**I. Hyrje.**

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 16 dhjetor 2022, shqyrtoi aktin normativ nr.17, datë 1.12.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar. Akti normativ u shqyrtua sipas rregullave të parashikuara në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Komisioni caktoi relatore, për këtë akt normativ, znj. Anila Denaj.

Në mbledhjen e Komisionit ishin të ftuar, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë:

- Znj. Delina Ibrahimaj, Ministre;
- Znj. Mimoza Dhëmbi, Drejtore e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit;
- Z. Endrit Lami, Drejtor i Drejtorisë së Analizave Makroekonomike dhe Statistikave.

**II. Baza ligjore.**

Akti normativ nr.12, datë 29.7.2022 është paraqitur për miratim nga Këshilli i Ministrave dhe shqyrtohet nga Kuvendi mbështetur në bazën kushtetuese e ligjore, si më poshtë:

- nenet 101 dhe 160 të Kushtetutës;

- nenin 46 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- rregullat e përcaktuara në kreun III të pjesës së dytë të Rregullores së Kuvendit.

Akti normativ shoqërohet me relacionin përkatës, sipas kërkesave të nenit 68 të Rregullores së Kuvendit. Miratimi i tij kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 3 të Rregullores së Kuvendit.

### **III. Qëllimi dhe përmbajtja e aktit normativ.**

#### *III.1. Zhvillimet ekonomike të deritanishme dhe ato të pritshme.*

Ekonomia e vendit, gjatë vitit 2022, vijoi zhvillimin me ritme pozitive. Pas rritjes së fortë të ekonomisë gjatë vitit 2021 prej 8.5 për qind, ritmi i rritjes gjatë vitit 2022 vazhdoi të jetë pozitiv. Gjatë 3-mujorit të parë 2022, ritmi i rritjes vazhdoi të jetë i ndjeshëm, 6.5 për qind.

Në 3-mujorin e dytë rritja vazhdoi të ishte pozitive, por me ritëm më të ngadalësuar, prej 2.2 për qind. Ky ngadalësim ishte rrjedhojë e situatës gjeopolitike ndërkombëtare, sulmit të Rusisë ndaj Ukrainës, i cili solli ngadalësim të ekonomisë dhe rritje të presioneve inflacioniste në të gjithë botën.

Rritja vjetore e inflacionit në vendin tonë, në muajin nëntor, ishte 7.9 për qind, ndërsa pritshmëritë për vitin 2022 janë në nivelin mesatar prej 6.5 për qind. Rritja e inflacionit krijoi pasoja negative afatgjata në rritjen ekonomike, në financat e biznesit dhe të familjeve dhe në pasigurinë e agjentëve ekonomikë për të ardhmen. Ajo solli rritje të kostove të prodhimit, ngadalësim të eksporteve dhe investimeve private, tkurrje të investimeve publike dhe shtrenjtim të importeve.

Për të mbajtur nën kontroll inflacionin dhe rreziqet përkatëse në ekonomi, bankat qendrore në të gjitha vendet rritën normat bazë të interesit dhe shtrënguan kushtet e financimit. Në këtë situatë, edhe Banka e Shqipërisë u orientua drejt normalizimit të politikës monetare, për të mbajtur nën kontroll inflacionin, duke synuar kthimin e tij në objektiv në gjysmën e parë të vitit 2024.

Megjithatë, kërkesa konsumatore u shfaq relativisht rezistente ndaj goditjeve. Ajo u rrit me norma të qëndrueshme edhe në tremujorin e dytë, e mbështetur nga rritja dinamike e punësimit dhe e pagave, nivelet e larta të kursimeve dhe paketat e rezistencës sociale.

Mbështetur në ecurinë e deritanshme të aktivitetit ekonomik dhe pritshmëritë deri në fund të vitit, rritja ekonomike për vitin 2022 parashikohet të jetë rreth 3.7 për qind.

#### **Treguesit fiskalë.**

*Të ardhurat e përgjithshme të buxhetit*, për periudhën janar-nentor 2022, u rritën me 2.7 miliardë lekë ose 0.5 pikë përqindje në krahasim me planin. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm, këto të ardhura janë rritur me 64 miliardë lekë ose 14 pikë përqindje.

Ritmi i rritjes së të ardhurave, në krahasim me një vit më parë, është më i lartë se ritmi mesatar i rritjes së inflacionit. Kjo flet për një ecuri pozitive të mbledhjes së të ardhurave.

Sipas zërave, rritja e të ardhurave në krahasim me planin, rezulton si më poshtë:

- *Të ardhurat nga tatimet dhe doganat* arritën vlerën 357 miliardë lekë, duke u realizuar në masën 100 për qind në krahasim me planin. Në krahasim me një vit më parë, këto të ardhura u rritën me 54 miliardë lekë ose 18 pikë përqindje. Këto të ardhura përbëjnë rreth 68 për qind të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit.

Rritja e këtyre të ardhurave është rrjedhojë e rritjes së ndjeshme të të ardhurave nga TVSH, si dhe rritjes së të ardhurave nga tatimi mbi fitimin. Të ardhurat nga taksat nacionale, tatimi mbi të ardhurat personale, akcizat dhe taksat doganore rezultojnë me mosrealizim në krahasim me planin.

- *Të ardhurat nga pushteti vendor* janë realizuar në masën 99 për qind në krahasim me planin, me një mosrealizim prej 0.3 miliardë lekësh. Këto të ardhura përbëjnë rreth 5 për qind të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit.
- *Të ardhurat nga fondet speciale* janë rritur me 4.3 miliardë lekë ose 4 pikë përqindje. Këto të ardhura përbëjnë rreth 21 për qind të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit.
- *Të ardhurat jotatimore* janë realizuar në masën 100.1 për qind në krahasim me planin. Këto të ardhura përbëjnë rreth 4 për qind të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit.

*Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit* arritën vlerën 513 miliardë lekë. Në krahasim me planin, këto shpenzime rezultojnë me mosrealizim për 74 miliardë lekë ose 12.6 pikë përqindje. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm, këto shpenzime janë rritur me 21.5 miliardë lekë ose 4.4 pikë përqindje. Sipas zërave, në krahasim me planin:

- *Shpenzimet korrente* rezultojnë me mosrealizim për 26 miliardë lekë ose 5.7 pikë përqindje. Këto shpenzime përbëjnë rreth 83 për shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm, këto shpenzime janë rritur me rreth 22 miliardë lekë ose 5.5 pikë përqindje.
- *Shpenzimet kapitale* rezultojnë me mosrealizim për 33 miliardë lekë ose 34.7 pikë përqindje. Këto shpenzime përbëjnë rreth 12 për shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit.

*Deficiti buxhetor* për periudhën 11-mujore, sipas parashikimit në fillim të vitit, ishte - 67 miliardë lekë. Në fakt, 11-mujori rezultoi me një suficit buxhetor prej 9.5 miliardë lekësh. Pritshmëritë për

vitin 2022 janë që deficitin buxhetor për vitin 2022 të jetë 4.2 për qind e PBB, nga 5.4 për qind i parashikuar në fillim të vitit.

*Borxhi publik* për vitin 2022, sipas parashikimeve, pritet arrijë nivelin 71.7 për qind e PBB, nga 78.8 për qind e PBB i parashikuar në fillim të vitit.

### *III.2. Vlerësimi nga agjencitë dhe institucionet financiare ndërkombëtare.*

#### *Agjencitë “Moddy’s” dhe Standard & Poor’s.*

Agjencitë ndërkombëtare të vlerësimit të kredibilitetit, “Moddy’s” dhe “Standard & Poor’s”, në rishikimin më të fundit të opinioneve të tyre, konfirmuan për vendin tonë, vlerësimin respektivisht me “B1” dhe “B+”, si dhe “me perspektivë të qëndrueshme”. Perspektiva e qëndrueshme pasqyron pikëpamjen e agjencive se Shqipëria mund të vazhdojë të menaxhojë rreziqet nga konflikti Ukrainë-Rusi.

Vlerësimet mbështeten nga perspektiva e moderuar e rritjes ekonomike të Shqipërisë dhe fleksibiliteti i saj monetar, nëpërmjet regjimit të kursit të lirë të këmbimit dhe rezervave valutore relativisht të larta.

Shqipëria do të rikthehet në pozicionin konsolidues fiskal, duke ulur borxhin publik gjatë viteve 2022-2025, pavarësisht goditjeve të jashtme, me të cilat po përballet vitet e fundit.

#### *Fondi Monetar Ndërkombëtar.*

Pas një rimëkëmbjeje të fortë në vitin 2021, ekonomia shqiptare ka ruajtur një ecure positive gjatë vitit 2022, pavarësisht tronditjes së ekonomisë globale nga lufta e Rusisë kundër Ukrainës.

Rritja reale e PBB-së pritet të arrijë në 3.7 për qind në vitin 2022, si pasojë e aktivitetit të fuqishëm në turizëm, pasuri të paluajtshme dhe shërbime. Rritja pritet të ngadalësohet në rreth 2 për qind në vitin 2023, duke reflektuar kushtet më të shtrënguara financiare, ngadalësimin në Europë dhe kufizimin e politikave mbështetëse.

Inflacioni pritet të arrijë kulmin në muajt e ardhshëm dhe duhet të fillojë të ulet në vitin 2023, duke u kthyer në objektivin e Bankës Qendrore prej 3 për qind nga mesi i vitit 2024.

Borxhi i qeverisë së përgjithshme pritet të bjerë më tej në 70 për qind të PBB-së në fund të vitit 2022, i ndihmuar nga rritja e vazhdueshme ekonomike dhe një deficit i pritshëm më i vogël në krahasim me vitin e kaluar. Borxhi pritet të jetë me tendencë rënëse, duke arritur në rreth 64 për qind të PBB-së në vitin 2027, por nevojat për financim bruto do të mbeten të konsiderueshme.

Rreziqet kryesore për perspektivën janë:

- Rritjet e mëtejshme të çmimeve të ushqimit dhe energjisë;
- Shtërngimi i kushteve financiare globale;
- Kushtet e pafavorshme të motit;
- Rritja e çmimeve të pasurive të paluajtshme.

Nevojitet një politikë e kujdesshme dhe vigjilencë për të garantuar stabilitetin makroekonomik dhe për të adresuar dobësitë.

### *III.3. Ndryshimet e mëparshme në buxhetin e vitit 2022.*

Buxheti i vitit 2022 është ndryshuar më parë me dy akte normative, si më poshtë:

- *Akti normativ nr.3, datë 12.3.2022*, i cili synonte akordimin e mbështetjes buxhetore për sektorin e energjisë elektrike dhe financimin e paketës së rezistencës sociale ndaj pasojave të krizës. Ky akt normativ ruajti të pandryshuar treguesit kryesorë makroekonomikë, si deficitin buxhetor dhe borxhin publik. Ai rriti të ardhurat dhe shpenzimet e përgjithshme të buxhetit respektivisht me të njejtën vlerë, 10 miliardë lekë.

Paketa e rezistencës sociale u parashikua në vlerën 6 miliardë lekë dhe u shpërnda me vendim të Këshillit të Ministrave për zbutjen e efekteve të krizës aktuale, për të siguruar mbështetjen e shtresave në nevojë, sektorit të transportit publik dhe sektorit të bujqësisë.

Gjithashtu, ky akt normativ parashikoi disa rialokime në shpenzimet korrente e kapitale, për të rritur efektivitetin e tyre.

- *Akti normativ nr.12, datë 29.7.2022*, i cili parashikoi:
  - ✓ Rritjen e të ardhurave të përgjithshme të buxhetit me 30 miliardë lekë, bazuar në rezultatet pozitive të mbledhjes së të ardhurave deri në atë periudhë;
  - ✓ Rritjen e shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit me 13 miliardë lekë, me qëllim shtrirjen e mëtejshme të periudhës së financimit të paketës së rezistencës sociale ndaj pasojave të krizës, me vlerë 6.1 miliardë lekë;
  - ✓ Reduktimin e huamarrjes së brendshme dhe të deficitit buxhetor në masën 17 miliardë lekë, për të siguruar qëndrueshmërinë e parametrave makroekonomikë të vendit.

#### *III.4. Përmbajtja e aktit normativ.*

Akti normativ nr.17, datë 1.12.2022 parashikon ndryshimin e tretë në buxhetin e vitit 2022.

*Nevoja* për aktin normativ lindi pas analizës, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të rezultateve të arritura në treguesit fiskalë të 11-mujorit dhe pritshmërive deri në fund të vitit. Nga kjo analizë, lindi nevoja për disa shtesa e ndryshime në buxhetin e vitit 2022, për të arritur një performancë optimale të treguesve fiskalë për periudhën e mbetur të vitit.

*Qëllimi* i këtij akti normativ është që të mundësojë realizimin në terma optimale të të ardhurave, shpenzimeve dhe treguesve të tjerë të buxhetit të vitit 2022, duke mbështetur zhvillimin e qendrueshëm të vendit.

Ndryshimet që parashikohen në aktin normativ janë:

*Së pari*, rritja e të ardhurave të përgjithshme të buxhetit me 5 miliardë lekë, duke reflektuar rezultatet pozitive të realizimit të tyre gjatë periudhës 11-mujore dhe vijimin e këtij trendi deri në fund të vitit, si dhe ndikimin e rritjes së çmimeve të mallrave dhe shërbimeve.

Në strukturë, rritja e të ardhurave parashikohet të vijë nga:

- Rritja me 5 miliardë lekë e të ardhurave tatimore (3 miliardë lekë nga TVSH dhe 2 miliardë lekë nga fondet speciale);
- Rritja me 2 miliardë lekë e të ardhurave jotatimore, në zërin “Kthim kapitali nga AIC”;
- Reduktimi me 2 miliardë lekë i të ardhurave nga grantet e huaja.

*Së dyti*, rritja me 5 miliardë lekë e shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit. Në shpenzimet buxhetore është ndjekur politika e reduktimit të shpenzimeve në zërat që kanë shënuar mosrealizim gjatë periudhës 11-mujore dhe rritjes në zërat që kanë pasur ecuri pozitive. Rritja e shpenzimeve, si dhe rialokimet midis zërave të shpenzimeve korrente e kapitale, synojnë optimizimin e realizimit të tyre për periudhën e mbetur të vitit pas aktit normativ.

Ndryshimi në shpenzimet parashikohet të vijë nga:

*a) Rritja e shpenzimeve me 30 miliardë lekë në zërat si më poshtë:*

- Rritja me 12.4 miliardë lekë e shpenzimeve për Fondin e Rindërtimit;
- Rritja me 5 miliardë lekë e shpenzimeve kapitale për projektet në vazhdim në infrastrukturë, në Programin “Transporti rrugor”, për avancimin e projekteve strategjike, si Tuneli i Llogarasë dhe Unaza e Tiranës, si dhe shlyerja e detyrimeve të prapambetura;

- Rritja me 2 miliardë lekë e shpenzimeve për projektet në vazhdim për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve në shkallë vendi, për përmirësimin e furnizimit me ujë të popullsisë dhe mbulimin e detyrimeve të prapambetura;
- Rritja me 2 miliardë lekë e shpenzimeve për Korporatën Shqiptare të Investimeve (AIC), në formën e transfertës kapitale për mbështetjen e projekteve të zhvillimit;
- Rritja me 2 miliardë lekë e shpenzimeve për aviacionin civil, për financimin e investimeve të nisura në infrastrukturën aeroportuale. Kjo rritje është kërkuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe synon zhvillimin e infrastrukturës ajrore në vendin tonë, në përputhje me politikat prioritare kombëtare dhe me standardet ndërkombëtare.
- Rritja me 1.2 miliardë lekë e shpenzimeve për Shoqërinë “Albgaz”, për të siguruar zbatimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit, të nënshkruara me disa kompani ndërkombëtare në këtë fushë. Ky financim parashikohet për të mbështetur politikat e gazifikimit të vendit, si dhe ndikon në rritjen e sigurisë energjitike, diversifikimin e burimeve energjitike dhe dekarbonizimin. Ky financim mbështet shoqërinë Albgaz, sha, e cila ka të ardhura modeste, kushte të vështira të rrjetit të transmetimit, si dhe jepet në mungesë të tregut të brendshëm në këtë fushë.
- Rritja me 1 miliardë lekë e shpenzimeve korrente për Policinë e Shtetit (për uniforma, karburant etj);
- Rritja me 0.8 miliardë lekë e shpenzimeve për mirëmbajtjen e rrugëve në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për të mundësuar shlyerjen e detyrimeve të prapambetura;
- Rritja me 0.7 miliardë lekë e shpenzimeve për projektet në vazhdim me financim të huaj për përmirësimin e sistemit të shëndetësisë dhe emergjenca Covid-19 me Bankën Botërore;
- Rritja me 500 milionë lekë për projektet në vazhdim në fushat e digjitalizimit dhe qeverisjes elektronike për Policinë e Shtetit dhe Drejtorinë e përgjithshme të Tatimeve;
- Rritja me 200 milionë lekë si financim shtesë për skemën kombëtare të fermerëve;
- Rritja me 250 milionë lekë e shpenzimeve për Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH), për financimin e infrastrukturës sportive në vend.
- Rritja me 70 milionë lekë e shpenzimeve për Federatën Shqiptare të Futbollit, për mbështetjen e Ekipit Kombëtar të Futbollit;
- Rritja me 150 milionë lekë për fondin rezervë të buxhetit të shtetit 2022.

*b) Reduktimi i shpenzimeve korrente e kapitale me 25 miliardë lekë, në zërat që kanë pasur mosrealizim si 12-mujor, ku ndër më kryesoret janë reduktimet në zërat si më poshtë:*

- Rreth (- 9.8) miliardë lekë shpenzime kapitale me financim të huaj (7.7 miliardë lekë kredi dhe 2 miliardë lekë grante), si rrjedhojë e ecurisë së ngadaltë në zbatim, problematikave me shpronësimet etj.
- Rreth (- 5.9) miliardë lekë shkurtime në planin e shpenzimeve për interesa, bazuar në realizimin e ulët të huamarrjes së pritshme nga burimet e brendshme dhe të huaja.
- Rreth (- 5.3) miliardë lekë shkurtime në shpenzimet kapitale me financim të brendshëm, si rrjedhojë e ecurisë së ngadaltë në nivel 11-mujor, problematikave me procedurat e prokurimeve, efekteve negative të rritjes së çmimeve të inputeve të ndërtimit etj.
- Rreth (- 1.9) miliardë lekë kursime nga paketa e rezistencës sociale, bazuar në përdorimet faktike të fondeve të planifikuara për këtë qëllim.
- Rreth (- 1) miliardë lekë shkurtime në shpenzimet e fondit të kompensimit të pronarëve, si rrjedhojë e performancës së ulët gjatë vitit 2022.

*c) Rritja e shpenzimeve për pushtetin vendor me rreth 1.2 miliardë lekë.*

Kjo rritje parashikohet kryesisht në transfertat e buxhetit të shtetit për pushtetin vendor. Sipas natyrës, ndryshimet në buxhetin vendor janë si më poshtë:

- Rriten me 1 miliardë lekë shpenzimet e transfertës specifike për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura. Kjo shumë është shpërndarë sipas njësive të vetëqeverisjes vendore, duke marrë si kriter peshën e detyrimeve të secilës njësi ndaj totalit të detyrimit të muajit dhjetor 2021, si dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore për periudhën 2018-2021. Ky fond do të përdoret për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, duke i dhënë përparësi detyrimit më të vjetër të papaguar. Bashkia Tiranë nuk përfshihet në shpërndarjen e transfertës specifike për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, për arsye se ka kapacitet të lartë në mbledhjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore.
- Rriten me 165 milionë lekë shpenzimet e transfertës specifike për sportin, përkatësisht për rikonstrukcionin e Pallatit të Sportit në Gjirokastër 100 milionë lekë dhe rikonstrukcionin e Pallatit të Sportit në Përmet 65 milionë lekë.
- Rritet me 70 milionë lekë pjesa e taksave të ndara që i transferohen buxhetit vendor, për shkak të realizimit të lartë të tatimit mbi të ardhurat personale dhe taksës së rentës minerare



në rang vendi. Kjo do të sjellë më shumë financim për buxhetin vendor, për të mundësuar ofrimin e më shumë shërbimeve publike për qytetarët.

- Shpërndahen, nga fondi rezervë i transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme, 70 milionë lekë për transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme për mbulimin e shpenzimeve të veprimtarive dhe funksioneve për ato njësi të vetëqeverisjes vendore që nuk kanë realizuar mjaftueshëm nivelin e të ardhurave, për të mos cenuar ofrimin e shërbimeve publike të domosdoshme.
- Reduktohet me 65 milionë lekë financimi i huaj vendor, për shkak të mosrealizimit të plotë deri në këtë periudhë.

**Së treti,** ruajtja e pandryshuar e deficitit buxhetor dhe borxhit publik.

*Deficiti buxhetor* për vitin 2022 pritet të jetë 3.9 për qind e PBB. Ky tregues është ndikuar nga ecuria pozitive e të ardhurave buxhetore për 11-mujorin 2022 dhe pritshmëria gjithashtu pozitive e realizimit të tyre në nivel vjetor. Kjo ka sjellë mbulimin e plotë të të gjitha nevojave për financim në kahun e shpenzimeve, të parashikuara në aktin normativ, që do të shërbejnë për sigurimin deri në fund të vitit 2022 të qëndrueshmërisë së parametrave kyç makrofiskalë.

**Së katërti,** borxhi publik për vitin 2022 pritet të jetë 68.9 për qind e PBB, duke qenë ndjeshëm më i ulët se parashikimi në fillim të vitit prej 78.8 për qind e PBB.

Ndërkohë që borxhi publik nuk ndryshon, shpenzimet për shërbimin e borxhit reduktohen me 6.96 miliardë lekë, nga të cilat 3 miliardë lekë janë për shërbimin e borxhit të brendshëm dhe 2.96 miliardë lekë janë për shërbimin e borxhit të jashtëm.

Parashikimi i shpenzimeve për interesa, në fillim të vitit 2022, ishte 50.8 miliardë lekë, duke u rritur ndjeshëm në krahasim me vitin 2021. Ky parashikim u mbështet në politikën monetare normalizuese të Bankës së Shqipërisë për rritjen e normave të interesit, me qëllin reduktimin e nivelit të inflacionit.

Në fakt, shpenzimet për interesa për periudhën 11-mujore janë reduktuar me 2 miliardë lekë dhe pritshmëritë për vitin 2022 janë për një reduktim të ndjeshëm në nivel vjetor. Ky reduktim ka ndodhur si në shpenzimet për interesa të borxhit të brendshëm, ashtu edhe të borxhit të jashtëm dhe është ndikuar nga këta faktorë:

- Reduktimi i huamarrjes së brendshme dhe të huaj;
- Përmirësimet në sektorin energjitik, të cilat krijuan mundësinë që operatori i energjisë elektrike të paguajë vetë detyrimin lidhur me borxhin e garantuar, duke ndikuar në reduktimin e nivelit të borxhit të grantuar nga buxheti i shtetit.

#### **IV. Përputhshmëria e aktit normativ me kushtetutën.**

Akti normativ nr.12, datë 29.7.2022 plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 101 të kushtetutës, si dhe të analizuara në vendimin nr.24, datë 10.11.2006 dhe vendimin nr.23, datë 16.4.2014 të Gjykatës Kushtetuese.

Këshilli i Ministrave analizoi realizimin e treguesve makroekonomikë e fiskalë për vitin aktual, deri në momentin e hartimit të aktit normativ dhe përcaktoi pritshmëritë për realizimin e tyre deri në fund të vitit. Në këtë proces, ai vlerësoi të nevojshëm dhe prioritar reflektimin në ligjin e buxhetit të rritjes së të ardhurave, si dhe përdorimin e tyre, së bashku me rialokimin e fondeve buxhetore, drejt projekteve prioritare dhe me ecuri të mirë.

Këshilli i Ministrave vlerësoi se këto ndryshime janë të nevojshme dhe duhet të zbatohen me urgjencë, për të mundësuar përdorimin e tyre për vitin buxhetor aktual. Për këtë arsye, Këshilli i Ministrave vlerësoi domosdoshmërinë e miratimit të tyre me akt normativ.

Gjithashtu, akti normativ plotëson edhe kriterin e përkohshmërisë, pasi vepron me fuqinë e ligjit për një periudhë maksimale prej 45 ditësh, deri në datën e miratimit të tij nga Kuvendi.

#### **V. Diskutimi në Komision.**

Ministrja e Financave dhe Ekonomisë analizoi zhvillimet kryesore makroekonomike për periudhën 11-mujore dhe pritshmëritë deri në fund të vitit. Ajo parashtrroi nevojën, synimet, përmbajtjen dhe impaktin e aktit normativ.

Relatorja theksoi se akti normativ është shumë i rëndësishëm, pasi:

- Reflekton në buxhetin vjetor rezultatet pozitive faktike të arritura në mbledhjen e të ardhurave;
- Shtesa e të ardhurave, së bashku me rialokimet në shpenzime, krijojnë mundësinë për përdorimin e fondeve buxhetore në projektet që kanë ecuri pozitive, duke rritur efikasitetin dhe efektivitetin e përdorimit të fondeve publike;
- Ruan të pandryshuar deficitin buxhetor dhe borxhin publik dhe për rrjedhojë, edhe qendrueshmërinë makroekonomike të vendit.

Gjatë diskutimit, anëtarët e Komisionit kërkuan informacione shtesë për aktin normativ, si dhe për realizimin e planit gjatë periudhës 11-mujore, për të cilat Ministrja e Financave dha informacionet përkatëse. Shumica e deputetëve e mbështetën projektligjin. Deputetët e opozitës u shprehën kundër tij.

## **VI. Përfundim.**

Mbështetur në mendimin e shumicës së deputetëve se akti normativ:

- është në përputhje me kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- ka ardhur dhe shqyrtohet në përputhje me Rregulloren e Kuvendit;
- pritet të sjellë rritjen e efektivitetit të përdorimit të fondeve buxhetore;

Komisioni e miratoi aktin normativ me shumicë votash.

**RELATORJA**

**Anila DENAJ**

**KRYETARI**

**Eduard SHALSI**